



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 56
Podujevë,
12 shkurt 2020

Në mbështetje të nenit 17 pika s të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 19 pika s të Statutit të Komunës dhe nenit 14 paragrafi 2 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/111 – 400, Drejtoria e Arsimit, publikon :

KONKURS

për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme për vitin akademik / shkollor 2019 - 2020

Kriteret e përgjithshme

Përfitues të bursave mund të jenë :

- Vetëm studentët e rregullt – viti i dytë (II) e tutje të regjistruar në fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studimet pasuniversitare – master dhe doktoratë
- Studentët përfitues të bursave universitare nga UP ose nga ndonjë organizatë tjetër qeveritare apo joqeveritare nuk do të mund përfitojnë bursën komunale pavarësisht plotësisht të kushteve të tjera të cekura më poshtë.
- Studentët duhet ta kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin konkurrojnë për bursë
- Studentët duhet të mos jenë përsëritës të vitit akademik
- Nxënësit e dalluar dhe talentë nga ndonjë fushë
- Të jenë banor të komunës së Podujevës

Kriteret e veçanta

Studentët të cilët kanë notë mesatare :

- mbi 9.00 vlerësohen me 25 pikë
- mbi 8.00 vlerësohen me 20 pikë
- mbi 7.00 vlerësohen me 15 pikë
- mbi 6.00 vlerësohen me 10 pikë

- Studentët dhe nxënësit në gjendje të vështirë ekonomike – shfrytëzues të asistencës sociale dhe ata me nevoja të veçanta vlerësohen me 15 pikë
- Studentët që studiojnë së bashku me një anëtar tjetër nga e njëjta familje vlerësohen me 15 pikë
- Studentët dhe nxënësit që nuk i kanë prindërit në jetë vlerësohen me 10 pikë – nëna kryefamiljare (të dëshmohet me dokument adekuat).
- Studentët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara vlerësohen me 10 pikë

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Vërtetimin se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2019 -2020
- Certifikata e notave - forma origjinale për studentë, ndërsa dëftesa për nxënës
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetim për shfrytëzimin e ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për punë sociale në Podujevë (kjo vlen për shfrytëzuesit që aktualisht marrin ndihmë sociale).

Vini re

Dokumentet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë në objektin e Komunës – rr. “ Nuhi Gashi “ , në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës, në mediat e shkruara dhe në ueb-faqen e Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Drejtorisë për Arsim dhe nga numri i atyre që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

**Drejtori
Agim Blakçori**

